Ndërrimi dhe ndarja e librave / Размена и поделба на учебници	Grumbullimi, kontrollimi dhe largimi i librave të dëmtuara / Собирање, проверување и отстранување на оштетени учебници	Arsimtarët klasor dhe lëndor / Предметни и одделенски наставници	Furnizimi i nxënësve me libra / Снабдување на учениците со учебници	Bibliotekist kujdestarët e klasor / Библиотекар, одделенски раководител	Shtator / Септември
Shënimi“Dita e Paqes” / Одбележувањена“Денот на мирот	Mbjellja e drunjëve / Засадувањенадрва	Arsimtarët klasor dhe lëndor, përvaqësues nga këshilli i prindërve / Предметни и одделенски Наставници и претставник од советот на родители	Gjelberimi i oborrit shkollor / Озеленување на училишниот двор	Ekipi ekologjik / Тимот за екологија	Shtator / Септември
Shënim i “Java e fëmijëve” / Одбележување на Детска недела	Grumbulim i mjeteve financiare / Собирање на парични средства	Arsimtaret klasor / Одделенски наставници	Zhvillimi i vlerave humanitare tek nxënësit / Развивање на хуманитарни вредности кај учениците	Kujdestarët klasave të I-rë / Класните раководители на 1 одд	Tetor / Октомври
Aksion humanitar me rastin e “Ditës së urisë” Хуманитарна акција по повод “Денот на гладта	Grumbullimi i mjeteve financiare në formë të vlerave me bona dhe grumbullim i ushqimit / Собирање на парични средства во вид на	Arsimtarët përgjegjës në bashkëpunim dhe përfaqësues nga këshilli i prindërve / Одговорните наставници во соработка претставник од советот на родители	Ndihmë për familjet me nevoja sociale në shkollën tonë / Помагање на социјално загрозени семејства од нашето училиште	Kujdestarët klasave / Класните раководители	Tetor / Октомври

	вредносни бодови и собирање на храна				
Aksion grumbullues / Собирна акција	Grumbullimi i ambalazhës plastike / Собирање на пластична амбалажа	Arsimtar klasor dhe lëndor / Предметни и одделенски наставници	Zhvillimi i ndërgjegjes mjedisore dhe mirëmbajtje e higjienës në hapësirat shkollore / Развивање на еколошката свест и одржување на хигиената во училишните простории	Arsimtar klasor dhe lëndor / Предметни и одделенски наставници	Shtator - Maj / Септември- мај
Aksion grumbullues / Собирна акција	Grumbullimi i letrave / Собирање на хартија	Arsimtar klasor dhe lëndor / Предметни и одделенски наставници	Zhvillimi i ndërgjegjes mjedisore dhe mirëmbajtje e higjienës në hapësirat shkollore / Развивање на еколошката свест и одржување на хигиената во училишните простори	Arsimtar klasor dhe lëndorë / Предметни и одделенски наставници	Shator- Maj / Септември - мај
Aksion me rastin e shënimit “ Dita e shkollës” / Собирна акција по повод одбележувањето на“Денот на училиштето	Grumbullimi i rrobave / Собирање облека	Arsimtarët klasor dhe lëndor, përfaqësues nga këshilli i prindërve / Предметни и одделенски наставници и претставник од советот на родители	Ngritja e ndërgjegjes humanitare të nxënësit dhe të rriturve / Подигање на хуманитарната свест кај учениците и возрасните	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници	Nëntor / Ноември
Aksion punues për shënimin e “Dita e drurit” / Работна акција за одбележување на “Денот на дрвото“	Mbjellja e drunjëve në lokacione të përcaktuara nga komuna dhe në oborrin e shkollës, rregullimin e klasëve, korridoreve / Засадување на садници во локација одредена од општината и во училишниот двор, уредување на училници, ходници	Arsimtarët klasor dhe lëndor, përfaqësues nga këshilli i prindërve / Предметни и одделенски наставници и претставник од советот на родители	Mbarështim i oborrit të shkollës / Оплеменување на училишниот двор	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници	Nentor / Ноември
Shënim i javës për luftë kundër sëmundjeve të varura /	Ligjërim dhe punëtori për luftë kundër sëmundjeve të mvarura /		Test diagnostik dhe test për evaluim / Дијагностички тест и тест за евалуација	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници	Nentor Ноември

Одбележување на недела на борба против болести на зависност	Предавање и работилница за борба против болести на зависност				
Shënimi i javës kundër SIDËS / Одбележување на недела на борба против СИДА	Ligjërim dhe punëtori për luftën kundër SIDËS / Предавање и работилница за борба против СИДА		Test diagnostik dhe test për evaluim / Дијагностички тест и тест за евалуација	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници	Dhjetor / Декември
Edukimi i nxënësve për dhënien e ndihmës së parë / Едукација на ученици за давање на прва помош	Punëtori me ushtrime praktike / Работилница со практични вежби	Nxënësit e kl. 7, 8, 9 në bashkëpunim me kryqin e kuq tv komunës së Tetovë / Ученици од 7, 8 и 9 одд.во соработка Црвен крст на општина Тетово	Nxënës të aftë për dhënien e ndihmës së parë gjatë lëndimeve të përditshme / Оспособени ученици за пружање на прва помош при секојдневни повреди	Ekipi i kryqit të kuq / Тимот на Црвен Крст	Shkurt / февруари
Shënimi i “Dita e ekologjisë” / Одбележување на “Денот на екологијата	Hepening pranveror mbjellje e luleve, barit dhe mirëmbajtja e tyre gjatë vitit / Пролетен хепенинг садење цвеќе, одржување во текот на годината трева и нивно	Arsimtarët klasor dhe lëndor, përfaqësues nga këshilli i prindërve / Предметни и одделенски наставници и претставник од советот на родители	Grumbullimi i mjeteve financiare për mirëmbajtjen kopshtare të hapësirës shkollore / Собирање на парични средства хортикултурно уредување на училиштниот простор	Ekipi ekologjik / Тимот за екологија	Mars / март
Shënimi i “Dita e higjienës” / Одбележување на “Денот на хигиената“	Ligjërim dhe punëtori / Предавање и работилница	Arsimtarët klasor dhe lëndor / Предметни и одделенски наставници	Përvetësimi i shprehive për mirëmbajtjen e higjienës personale dhe higjienës shtëpiake / Стекнување навики за одржување на лична хигиена и хигиена во домовите	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници	Prill / Април
Aksion humanitar me rastin “Java e solidarizimit” / Хуманитарна акција по повод недела на солидарноста	Grumbullim i mjeteve financiare / Собирање на парични средства		Motivimi i nxënësve për ngritjen e ndërgjegjes për solidaritet / Мотивирање на учениците за подигање на солидарната свест	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници	Maj / мај

10. Organizimi dhe pjesëmarrja e nxënësve /
10. Ученичко организирање и учество

Nëpërmjet të funksionimit të trupave të nxënësve kanë mundësi që demokratisht të marrin pjesë në shqyrtimin, miratimin e të gjitha pyetjet rreth jetës shkollore. Mësojnë të kenë vetëbesim dhe një fotografi pozitive për vetëveten, ta shprehin mendimin e tyre si dhe ta respektojnë mendimine tjetrit, të marrin akcione dhe të bëjnë ndryshime dhe të sjellin vendime. Nëpërmjet të funksionimit të Parlamentit të nxënësve përparon procesi i nxënjes në marrjen e iniciativës dhe aktivizimin e tyre.

Në fillim të vitit shkollor anëtarë të Parlmentit të nxënësve delegohen nga bashkësia e klasës. Në vitin shkollor 2025/2026, zgjedhja e avokatit të nxënësve do të bëhet në muajin shtator.

Përmbajtja / qëllimet:

- Formimi i Parlamentit të nxënësve;
- Përpilimi i Programit për punë;
- Përcaktimi i prioriteteve dhe veprimi;
- Përpilimi i planeve për iniciativë dhe realizim të tyre;
- Vlerësimi dhe promovimi i rezultateve të arritura.

Учениците преку функционирањето на ученичките тела имаат можност демократски да учествуваат во разгледувањето ирешавањето на сите прашања од ученичкиот живот. Учат да развиваат самодоверба и позитивна слика за себе, да го изразуваат своето мислење и да го почитуваат туѓото, да превземаат акциии да внесуваат промени, да донесуваат одлуки. Преку работата на Ученичкиот парламент се унапредува процесот на ученичка иницијативност и активизам.

На почетокот на учебната година членовите на Ученичкиот парламент се делегираат од класната заедница. Во учебната 2025/2026 година изборот на учениците адвокат ќе се изврши во септември.

Содржини / цели:

- Формирањена Собрание на студенти;
- Изготвување на Програма за работа;
- Определување на приоритети на делување;
- Изготвување на планови за иницијатива и акција и нивна реализација;
- Вреднување и промовирање на постигнатите резултати.

11. Aktivitetet jashtëshkollore / 11. Вон училишни активности

11.1. Ekskursione, shëtitje dhe mësim në natyrë / 11.1. Екскурзии, излети и настава во природа

Ekskursionet dhe shetitjet e planifikuara në vitin shkollor 2025/2026 /
Планирани екскурзии и прошетки во учебната 2025/2026 година

Sipas Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskurzioneve, shëtitjeve dhe aktiviteteve tjera jashtëshkollore me nr. 12-13487/1 të datës 19.11.2019, SHFK "Naim Frashëri"-Tetovë, ka përgatitur plan për realizimin e ekskursioneve, mësimit në natyrë dhe shëtitjeve për vitin shkollor 2025/2026	Според Правилникот за начинот на изведување на екскурзиите,излетите и другите вонучилишни активности со бр. 12-13487/1 од 19.11.2019 г, ООУ "Наим Фрашери"-Тетово изготви план за реализација на екскурзии, настава во природа и излети за учебната 2025/2026 год.

Klasa	Relacioni	Koha	Qëllimi i shëtitjes - ekskurzionit	Përgjegjësi
I	Shetitje deri ne 30 km nga Komuna e Tetovës	X, V	Njohuri, zgjerimi dhe përforcimi i njohurive të fituara për regjionin e rrethinës së Tetovës edhe atë komunikacioni, pasuritë natyrore, objektet ekonomike dhe turistike etj. Do të vizitohen: Xhamia e Larme, Arabati Baba Teqe. Organizimi do të realizohet, me prindërit si dhe shkuarja dhe ardhëja do të realiyohet në këmbë.	Hurije Isaku
II	Shetitje deri ne 30 km nga Komuna e Tetovës	XII, V	Zgjerimi dhe përforcimi i njohurive të fituara për regjionin e Malit Sharr dhe kompleksin e turizmit dimëror Kodra e Diellit edhe atë – reliefi, hidrografia, komunikacioni, pasuritë natyrore, objektet ekonomike dhe turistike nga lëndët shkencat natyrore, gjuhë amtare, ars. fizik dhe shën., ars. figurativ etj. Do të vizitohen: Manastiri i Leshkës "Shën Anastatij", Qendra rekreative dimërore-Kodra e Diellit. Organizimi teknik i shetitjes nga "Bashkim Tursi", me vetë finansim të nxënësve.	Arlinda Loki
III	Shetitje deri ne 30 km nga Komuna e Tetovës Ekskurzion njëditor	XII, V	Përfitimi, zgjerimi dhe përforcimi i njohurive të fituara për regjionin e Maqedonisë Malin Sharr dhe kompleksin e turizmit dimëror Kodra e Diellit edhe atë – reliefi, hidrografia, komunikacioni, pasuritë natyrore, objektet ekonomike dhe turistike nga lëndët shkenca natyrore, gjuhë etj. Do të vizitohen: Saraj, Qendra rekreative dimërore-Kodra e Diellit. Organizimi teknik i shetitjes nga "Bashkim Tursi", me vetë finansim të nxënësve.	Valbona Ismaili
IV	Shetitje deri ne 50 km nga Komuna e Tetovës	XII, V	Vizita dhe njohja me regjionin e Maqedonisë edhe atë – reliefi, hidrografia, flora dhe fauna, komunikacioni, pasuritë natyrore, dhe objektet turistike sipas lëndëve. Realizimi i qëllimeve recreative. Do të vizitohen: Kompleksi turistik Kodra e Diellit dhe në	Fatime Beluli

			Mavrovë. Organizimi teknik i shetitjes nga “Bashkim Tursi”, me vetë finansim të nxënësve.	
V	Shetitje deri ne 50 km nga Komuna e Tetovës -Mësim në natyrë	XII, V	Shëtitje dhe mësim në natyrë, zgjerimi dhe përforcimi i njohurive të fituara për regjionin e Maqedonisë edhe atë, reliefi, hidrografia, flora dhe fauna, komunikacioni, pasuritë natyrore, objektet e ekonomike e turistike etj. Përmes vëzhgimit të drejtëpërdrejtë nxënësit do të njihen me dukuritë dhe objektet natyrore të Maqedonisë. Zhvillojnë interes për natyrën dhe ndërtojnë shprehi ekologjike. Njihen me kulturën, traditat dhe të kaluarën e regjionit. Zhvillojnë dhe manifestojnë emocione pozitive mes nxënësve, interes për rekreim dhe jetë të shëndoshë. Ndikimi ne socializimin e nxënësve. Do të vizitohen: Kompleksi turistik Kodra e Diellit. Mësimi në natyrë në Strugë i cili realizohet ne muajin maj, në kohëzgjatje prej 3-5 ditë. Organizimi teknik i shetitjes nga “Bashkim Tursi”, me vetë finansim të nxënësve.	Arbnora Abdullahi
VI	Shetitje deri ne 50 km nga Komuna e Tetovës	XII, V	Përfitimi, zgjerimi dhe përforcimi i njohurive të fituara për regjionin e Maqedonisë në veçanti për Malin Sharr dhe kompleksin e turizmit dimëror Kodra e Diellit edhe atë, pasuritë natyrore, objektet ekonomike dhe turistike si dhe hidrocentralet. Përmes vëzhgimit të drejtëpërdrejtë nxënësit do të njihen me dukuritë dhe objektet natyrore të Maqedonisë perendimore; Zhvillojnë interes për natyrën dhe ndërtojnë shprehi ekologjike. Njihen me kulturën, traditat dhe të kaluarën e regjionit. Zhvillojnë dhe manifestojnë emocione pozitive mes nxënësve, interes për rekreim dhe jetë të shëndoshë Do të vizitohen: Kompleksi turistik Kodra e Diellit. Ekskurzion ne Strugë,do të vizitohen Hidrocentralet e Vrutokut, Struga: Burimi i lumit Drini i Zi, Liqeni i Ohrit, Muzeu biologjik, objekte turistike në Strugë. Organizimi teknik i shetitjes nga “Bashkim Tursi”, me vetëfinansim të nxënësve.	Laureta Fetahi

VII	Shetitje deri ne 50 km nga Komuna e Tetovës	X-XII II- V	Përmes vëzhgimit të drejtëpërdrejtë nxënësit do të njihen me dukuritë dhe objektet natyrore të Maqedonisë perendimore; Zhvillojnë interes për natyrën dhe ndërtojnë shprehi ekologjike. Njihen me kulturën, traditat dhe të kaluarën e regjionit Zhvillojnë dhe manifestojnë emocione pozitive mes nxënësve, interes për rekreim dhe jetë të shëndoshë në ajër të pastër. Do të vizitohen: Kompleksi turistik Kodra e Diellit dhe ekskurzion ne Strugë. Organizimi teknik i shetitjes nga "Bashkim Tursi", me vetë finansim të nxënësve.	Leonora Ferati
VIII	Shetitje deri ne 50 km nga Komuna e Tetovës	XII, V	Përforcimi i njohurive të fituara për regjionin e Maqedonisë perëndimore edhe atë pasuritë natyrore, objektet e ekonomike e turistike etj. Përmes vëzhgimit të drejtëpërdrejtë nxënësit do të njihen me dukuritë dhe objektet natyrore të Maqedonisë perendimore; Zhvillimi i interesit për natyrën si dhe ndërtimi i shprehive ekologjike. Zhvillojnë dhe manifestojnë emocione pozitive mes nxënësve, interes për rekreim dhe jetë të shëndoshë Do të vizitohen: Kompleksi turistik Kodra e Diellit ose Mavrovë si dhe në Strug. Organizimi teknik i shetitjes nga "Bashkim Tursi", me vetëfinansim të nxënësve.	Sherife Alili
IX	Shetitje deri ne 50 km nga Komuna e Tetovës	X-XII II- V	Fitimi dhe përforcimi i njohurive të fituara për regjionin e Maqedonisë në Mavrov në kompleksin e turizmit duke vëzhguar pasuritë natyrore dhe turistike etj. Përmes vëzhgimit të drejtëpërdrejtë nxënësit do të njihen me dukuritë dhe objektet në Maqedoni. Zhvillojnë interes për natyrën dhe ndërtojnë shprehi ekologjike. Njihen me kulturën, traditat dhe të kaluarën e regjionit Zhvillojnë dhe manifestojnë emocione pozitive mes nxënësve, interes për jetë të shëndoshë. Do të vizitohen: Kompleksi turistik Kodra e Diellit ose Mavrovë Ekskurzion në Mavrov ku do të vizitohen terenet sportive të skijimit. Organizimi teknik i shetitjes nga "Bashkim Tursi", me vetë finansim të nxënësve.	Merije Kurtishi

11.2. Të dhëna për nxënësit e shkollave fillore të përfshirë në aktivitete jashtëshkollore /
11.2. Податоци за ученицитеод основното училиште вклучени во вонучилишни активности

Pas mbarimit të orëve mësimore, nxënësit kanë mundësinë të përfshihen në aktivitete jashtëshkollore të ofruara nga shkollat e gjuhëve të huaja, klubet e sportive. Nxënësit gjithashtu përfshihen në aktivitete të ndryshme jashtë shkollës siç janë shkolla fillore e muzikës, shkolla e baletit, shkolla e vallëzimit, akademia sportive etj. Gjatë vitit shkollor është planifikuar të mblidhen të dhëna për numrin e nxënësve për klasë që ndjekin aktivitete të tilla.	Позавршувањето на часовите, во самото училиште, учениците имат можност дасе вклучат во вонучилишни активности кои ги нудат училиштата за странски јазици,кошаркарските клубови. Исто така учениците се вклучуваат и во разно видни активности надвор од училиштето како што се основно музичко училиште, балетско училиште, училиште за танц, спортска академија и сл. Во текот на учебната година се планира да се соберат податоци за бројот на ученици по паралелки што посетуваат вакви активности.

12. Gara për nxënësit / 12. Ученички натпревари

Shkolla e cila në kontinuitet investon në zhvillimin e saj krijon klimë pozitive dhe stimulative dhe nxënës të cilët do të japin maksimumin e tyre për realizimin e afiniteteve dhe shkathtësive personale. Kanalizimi i drejtë i energjisë të cilën e bartë nxënësi në vete dhe mundësia të përsoset sipas afiniteteve është detyrë me përgjegjësi e shkollës, e cila e çon nxënësin në arritjen e sukseseve më të mëdha. Çdo nxënës krenohet me të arriturat e tij personale, si dhe me arritjet në të cilat e mban emrin e shkollës. Çelësi i suksesit është tek të gjithë në të cilët e nxisim motivin e dëshirës për afirmim të nxënësve në shoqëri. Për atë qëllim nxënësit e shkollës sonë në kontinuitet marrin pjesënë gara nga fusha të llojllojshme dhe nivele të ndryshme. Mënyrën e organizimit të nxënësve nëpër gara nga lëndë të caktuara në nivele shtetërore, komunale dhe rajonale i përcakton Ministria, në bashkëpunim me BZHA. **Gjatë organizimit dhe pjesëmarrjen nëpër gara në shkollë respektohen rregullat e parapara për atë qëllim:** ▪ Shërbimi i shkollës në kohë shfaq planin në tabelën e informimit sipas të cilës do të realizohen garat shkollore; ▪ Garë shkollore e organizon ekipi së paku nga tri arsimtarë, prej ku njëri është përgjegjës me programin vjetore të shkollës; ▪ Dy ditë para mbajtjes së garës sipas lëndës së paraparë vijon lajmërimi i cili do të lexohet në të gjitha paralelet dhe do të përmban informatë të plotë për të gjithë nxënësit;	Училиштето кое континуирано вложува во својот развој и создава позитивна, продуктивна и стимулативна училишна клима создава и ученици кои ќе го вложат својот максимум за реализацијата на сопствените афинитети и вештини. Правилното канализирање на енергијата која ја носи во себе ученикот и можноста да се надградува според афинитетите е одговорна задача на училиштето, кое го води ученикот кон постигнување на поголеми успеси. Секој ученик се гордее со своите лични постигнувања, како и со постигнувањата кои ги носи во име на училиштето. Клучот на успехот лежи во сите нас кои ги поттикнуваме мотивот за само докажување на учениците и желбата за афирмација во општеството. За таа цел учениците од нашето училиште континуирано учествуваат на натпревари од различни натпреварувачки подрачја и од различно ниво. Начинот на организирање и изведување на натпреварите на учениците по одделни предмети на општинско, регионално и државно ниво го утврдува Министерот, во соработка со Бирото. **При организирање и учество на натпревари во училиштето се почитуваат правилата кои се утврдени за таа цел:** ▪ Училишната служба навремено истакнува План на огласна табла според кој ќе се реализираат и спроведуваат училишните натпревари; ▪ Училиштен натпревар организира тим од најмалку тројца наставници, од кои еден е назначен за одговорен со Годишната програма на училиштето; ▪ Два дена пред одржувањето на натпреварот по предвидени от предмет следува соопштение кое ќе

- Rezultatet e garës së zhvilluar personat përgjegjës duhet ti shfaqin në tabelë për informim një javë pas garës (ndeshjes);
- Gojarisht informohen për rezultatet para të gjithë pjesëmarrësit e garës;
- Ekipi I formon procesverbal nga gara shkollore dhe raport për rezultatet;
- Nxënësi ka të drejtë të paraqitet dhe të marrë pjesë së paku në dy gara shkollore, gjegjësisht vetëm në dy lëndë mësimore;
- Ndonëse nxënës i njëjtë fiton vendin e parë në dy gara atëherë mundet të mere pjesë në të dyja garat komunale, shtetërore sipas vet dëshirës së tij nëse ka terminë të përshtatshme;
- Në garat komunale /rajonale/shtetërore mundet të merë pjesë dhe fituesi I vendit të dytë në qoftëse i pari tërhiqet për shkaqe të arsyeshme;
- Nxënësi rregullisht duhet ti vijon orët përgatitore që mban arsimtari-mentor si dhe ti kryen detyrat e caktuara;
- Nxënësi dhe mentori duhet të angazhohen për bashkëpunim dhe përgatitje më të lartë për garat që paraprijnë;
- Mentori në kohë ti dorëzon materialet prej të cilave do të akumulohen të dhëna nga disiplina të caktuara.

Gjatë mbajtjes së garave duhet të respektohen rregullat në vijim:

- Të bëhet lista e nxënësve qe do të marin pjesë në garën;
- Të zgjidhet komision nga arsimtarë kompetent lëndorë;
- Komisioni të përpilon test për zbatimin e garës shkollore;
- Testi duhet të jetë I standardizuar me detyra për dituri të nivelit të lartë të njohurive;
- Caktohet koha, vendi dhe mënyra e realizimit të garës shkollore;
- Dy ditë para garës së paraparë të lexohet lajmërimi në të gjitha paralelet;
- Respektimi i kornizës kohore e planifikuar të planit;
- Zhvillimi i garës në një atmosferë të qetë me një kornizë kohore të paracaktuar;
- Prania e Komisionit garues.

Nëse mentori e përgatit nxënësin për gara të nivelit më të lartë, atëherë duhet të kemi kujdes që:

- Arsimtari-mentor rregullisht nëpërmjet mësimit

се прочита во сите паралелки и ќе содржи навремена и комплетна информација за учениците;
- Резултатите од спроведениот натпревар одговорните да гиистакнат на огласна табла најдоцна една седмица по одржаниот натпревар;
- Усна информација за резултатите да биде презентирана пред сите учесници во натпреварот;
- Тимот составува записник од реализираниот училиштен натпревар и извештај за резултатите;
- Ученикот има право да се пријави т.е даучествува најмногу на два училишни натпревари, односно само на два наставни предмета.
- Доколку ист ученик освои прво место на двата натпревари, тогаш може да учествува на двата Општински, Регионални, Државни натпревари само по сопствена желба иако постои соодветна временскаразлика меѓу термините од најмалку една седмица;
- На Општински, Регионален, Државен натпревар може да учествува и второ рангираниот доколку првиот се откаже од оправдани причини;
- Ученикот редовно да ги посетува подготвителните часови од страна на наставникот- ментор и да ги извршува поставените задачи;
- Ученикот и менторот да се залагаат за што поголема соработка и подготовка за претстојните натпревари;
- Менторот навремено да доставува материјали од кои ќе се црпат дополнителни знаења во соодветната дисциплина.

Завреме на натпреварот треба да се почитуваат следниве правила:

- Да се изготви список на ученици на натпреварот;
- Да се избере Комисија од соодветни предметни наставници;
- Комисијата да изготви тест за спроведување на училишниот натпревар;
- Тестот да биде стандардизиран со задачи на повисоко ниво на знаење;
- Да се договори време, место и начин на реализација на училишниот натпревар;
- Два дена пред предвидениот натпревар да се прочита соопштение восите паралелки;
- Почитување на предвидената временска рамка од планот;
- Спроведување на натпреварот во беспрекорно тивка атмосфера со однапред утврдена временска рамка;
- Присуство на Комисијата на натпреварот.

Во колку менторот го подготвува ученикот за натпревар од повисок ранг, тогаш се внимава на следново:

- Наставникот - ментор редовно преку додатна наставаго подготвува ученикот;

shtues ta përgatis nxënësin;

- Arsimtari-mentor duhet të jetë rregullisht në dispozicion për mbështetje në mësimin e nxënësve që përgatiten;
- Të krijohet ekip nga arsimtarë përkatës të cilët kanë për obligim të kontrollojnë rregullshmërinë në kryerjen e obligimeve gjatë përgatitjeve për garat e radhës;
- Hapet dosje për çdo lëndë mësimore në të cilën regjistrohen aktivitetet, prania, fletore dhe materialku realizohen ushtrimet përgatitore;
- Dosja është e kapshme për shërbimin profesional dhe Drejtorin në qoftë se duan ta shfletojnë;
- Në përgatitjet duhet të përfshihet edhe materiali nga programimësimor;
- Lajmërim në kohë të duhur rreth pjesëmarrjes të nxënësve dhe arsimtarëve të tjerë;

Këshilli i arsimtarëve dhe Unioni i nxënësve munden të propozojnë ndryshim të këtyre rregullave për ndryshimet vendoset duke u arritur koncenzus sipas regullativave ligjore dhe dokumenteve të tilla në fuqi.

Sipas mundësive në përputhshmëri me Rregulloren për shpërblimin e nxënësve shkolla do të mundëson shpërblime simbolike dhe diploma, falënderime për nxënësit më të mire.

- Наставникот - ментор да биде редовно на располагање за поддршка во учењето на подготвувани ученици;
- Се формира тим од одговорни наставници чија обврска ќе биде да ја контролираат редовноста во извршувањето на обврските во насока на подготовките за претстојните натпревари;
- Се отвара папка по секој наставен предмет во која се забележуваат активностите, присуството, тетратката и материјалите со кои се реализираат подготвителните вежби;
- Папката е достапна за Стручната служба и Директорот доколку сакаат да ја разгледаат;
- Во подготовките да се вклучи и материјал од Наставната програма;
- На време соопштување и договор околу учеството на другите ученици и наставници.

Наставничкиот Совет или Ученичката заедница можат да предложат измени на овие правила. За измените се решава со постигнување консензус и согласно законските регулативи и слични документи на сила.

Во рамките на можностите и согласно Правилникот за наградување на ученици, училиштето ќе овозможи симболични награди и дипломи, пофалници за најдобрите ученици.

Kalendari i garave të planifikuara në vitin shkollor 2025/2026 / Календар за планирани натпревари во учебната 2025/2026 година

Lënda/fushat garuese Предмет / Натпревар подрачје	Arsimtarët përgjegjës / Одоговрни наставници	Klasa / Одделение	Gara shkollore / Училиштен натпревари	Gara komunale / Општински натпрвар	Gara regjionale / Регионален натпревар	Gara shtetërore / Државен натпревар	Gara nderkombetare / Меѓународен натпревар
Gjuhë Shqipe / Албански јазик	Hajrie Sheapi Minevere Neziri laura Bexheti Flutura Beluli Merije Kurtishi	VI, VII, VIII, IX	Mars / Март	Prill / Април	Maj / Maj	Maj / Maj	
Gjuhë maqedonase / Македонски јазик	Sherife Alili	VIII, IX	Mars / Март	Prill / Април	Maj / Maj	Maj / Maj	
Gjuhë angleze / Англиски јазик	Leonora Ferati Ramije Krtishi Nedmiran Beqiri Viola Luma	VI, VII, VIII, IX	Shkurt / Февруари		Mars / Март	Shkurt / Фебруар	
Gjuhë angleze / Англиск ијазик	Blerim Karemani Mirlinda Alili Amira Sabriu Edona Islami	IV, V	Maj / Maj			Mars / Март	
Gjuhë frenge Француски јазик	Blerta Ibrahimi	VI, VII, VIII	Shkurt / Февруари				
Gjuhë gjermane / Германски јазик	Dorentina Durmishi Havushe Huseini	VI, VII, VIII	Shkurt / Февруари				
Matematikë / Математика	Arta Halili Qetabie Emini Kushtrime Dauti Burbuqe Demiri	VI, VII, VIII, IX	Shkurt / Февруари		Mars–prill / март–април	Maj / Maj	
Histori / Историја	Senija Etemi Leonida Alili	VI, VII, VIII, IX	Mars / Март		Prill / Април	Maj / Maj	
Gjeografi / Географија	Jusuf Ademi Ardonit Durmishi Avdilmexhit Imeri	VI, VII, VIII, IX	Mars / Март		Prill / Април	Maj / Maj	
Informatikë / Информатика	Ilirjan Aliu	VI, VII, VIII, IX	Prill / Април			Maj / Maj	
Biologji / Биолигија	Suzana Ramadani Ermira Dehari Lirije Ramadani	VI, VII, VIII, IX			Prill / Април	Maj / Maj	
Shkenca natyrore / Природни науки	Emine Rexhepi	V				Prill / Април	
Kimi Хемија	Hanife Ameti Elvana Aliti	VIII, IX				Mars / Март	

13. Avancimi i multikulturalizmit, interkulturalizmit dhe integrimit ndëretnik / 13. Унапредување на мултикултурализмот, интеркуртуларизмот и меѓуетничката интеграција

Marrëdhëniet në shkollë ndërmjet të gjitha strukturave

Në punën e deritanishme të shkollës sonë ekziston një klimë pozitive dhe marrëdhënie të mirandërmjet të gjithë të punësuarve në shkollë, pa dallim të hierarkisë dhe pozitës së tyre dhe përkatësisë etnike dhe fetare. Probleme dhe situata të konfliktit zgjidhen me diskutim konstruktiv dhe respekt të ndërsjellë. Shpesh organizohen debate në të cilat bëhet analizë e komunikimit tonë të përbashkët me qëllim të ngritjes së cilësisë së saj.

Gjithashtu, nuk mbesin edhe shoqërimet e përbashkëta dhe shënimet e ngjarjeve dhe datave të rëndësishme, pastaj ekskursionet, vizitat e organizuara, organizimi dhe pjesëmarrja në lojërat sportive në të cilat përfshihen shumica e të gjitha strukturave në kolektiv. Përveç kësaj, shumë shpesh në aktivitetet përfshihen edhe nxënësit, prindërit dhe disa anëtarë të vetëqeverisjes lokale, që në mënyrë plotësuese jep kontribut për thellimin e bashkëpunimit dhe promovimit të vlerave të njeriut. Këto aktivitete çdo herë planifikohen jashtë orarit të punës dhe nuk pengojnë në zhvillimin e rregullt të procesit edukativo-arsimor.

Aktivitete të planifikuara për vitin shkollor 2025/2026 janë dhënë në tabelën në vijim:

Односи во училиштето меѓу сите структури

Во досегашната работа на нашето училиште постои позитивна клима и добри односи меѓу сите вработени во училиштето, без разлика на нивната хиерархија и подреденост и етничка и верска припадност. Проблеми и конфликтни ситуации се решаваат со конструктивна дискусија и почитување. Често се организираат работилници, дебати на кои се прави анализа на нашата заедничка комуникација со цел подигнување на квалитетот на истата.

Исто така не изостануваат и заедничките дружења и одбележувања на битнинастани или датуми, потоа екскурзии, организирани посети, организирање и учество во спортски игри во кои се вклучуваат мнозинството од сите структури воколективот. Освен тоа, многу честово активностите севклучени иучениците, родителите и некои членови на локалната самоуправа, што дополнително дава придонес за продлабочување на соработката и промовирање на човечките вредности. Овие активности секогаш се планираат на двор од работното време и не попречуваат во редовното одвивање на воспитно-образовниот процес.

Планираните активности за учебната 2025/2026 година се дадени со следнава табела:

Aktivitetet e planifikuara për zhvillimin e marrëdhënieve të mira ndërnjerëzore / Планирани активности за развивање на добри меѓу човечки односи

Muaji / Месец	Aktivitetet / Активности	Target relacionet / Целни релации	Vendi i realizimit / Место на реализација
VIII	Përbërja e ekipit nga strukturat e shkollës për analizën e pikave kritike në komunikim / Составување тим од училишните структури за анализа на критичките точки во комуникацијата Ekipin e përbëjnë / Тимот го сочинуваат: drejtori / директор	Ndërmjet të punësuarve / Меѓу вработени	Shkollë / Училиште
IX	Hartimi i planit të aktiviteteve dhe miratimi i tij në mbledhjen e përbashkët të të gjithë të punësuarve / Изготвување план на активности и усвојување на истиот на заеднички состанок на сите вработени	Ndërmjet të punësuarve / Меѓу вработени	Shkollë / Училиште
X	- Ekskursion i së bashku me nxënësit dhe të gjithë të punësuarit, tradicionalisht organizohen duele sportive nxënës - mësimdhënës në volejboll dhe futboll /	Nxënës, të punësuar / Ученици, вработени	Në fushën e sportit / Спортското игралиште

	- Екскурзијаза едно со учениците и ситевработени, традиционално се организираат ученичко-наставнички спортски дуели во одбојка, и фудбал.		
XI	Ndeshje sportive-volejboll dhe festa fetare - Bajram / Спортски Натпревар-одбојка и верски празник - бајрам	Të punësuar / Вработени	Shkollë / Училиште
XII	Festimi me rastin e Festave të Vitit të Ri / Прослава по повод Нова Година	Të punësuar / Вработени	Objektihotelierik Угостителскиобјект
III	Festimi me rastin e Ditës së Gruas-8 Marsi / Прослава по повод Денот на жената-Осми март	Të punësuar / Вработени	Objekti hotelierik / Угостителски објект
IV	1 prilli-Dita e shakasë, maskarada / 1-ви април-Ден на шегата, маскенбал	Të punësuar-nxënës / Вработени-ученици	Shkollë / Училиште
	-Ndeshje sportive volejboll ndërmjet shkollës nga Komuna me përfaqësuesit e përfshirë nga Vetëqeverisja Lokale / -Спортски натпревар одбојка меѓу училишта од Општината со вклучени претставници од Локалната Самоуправа	Të punësuar, vetëqeverisja lokale / Вработени, локална самоуправа	Shkollë / Училиште
VI	Ekspozita shitëse / Продажна изложба	Nxënës, prind dhe të punësuar / Ученици, родители, вработени	Shkollë / Училиште
VI	Ekskursioni i të punësuarve me vetë financim dhe ndihmë nga Sindikata / Екскурзија на вработените со самофинансирање и помош од Синдикатот	Të punësuar / Вработени	Sipas marrëveshjes / Според договор

Programi për Integrim ndëretnik në arsim

Një komponent i rëndësishëm në procesin edukativo - arsimor dhe në zhvillimin e përgjithshëm të individit është bashkëjetesa e të gjitha grupeve etnike në komunitet. Përveç shumë titujve për këtë temë në tekstet shkollore për nxënësit, do të realizohen edhe aktivitete të ndryshme në shkollë.

Me qëllim për të ruajtur multikulturalizmin, planifikohet të organizohen shumë evinemente në shkollë dhe jashtë saj, në bashkëpunim me komunitetin lokal dhe shkollat e tjera të cilët gjithashtu e kanë këtë komponent.

Në shkollën tonë do të realizohen lloje të ndryshme të ngjarjeve tematike, ekskursione, shfaqje, maskenballa dhe ahengje. Qëllim i të njëjtave është që përmes argëtimit dhe krijimtarisë të njohin zakonet dhe kulturat e shokëve të tyre nga grupet e ndryshme etnike. Në shtojcë jepet plani aksionar në kuadër të këtij komponenti të multikulturalizmit.

Програма за Меѓуетничка интеграција во образованието

Важна компонента во воспитно-образовниот процес и во целокупниот развојна индивидуата е соживот на сите етнички групи во заедницата. Покрај многу бројните наслови на оваа тема во учебниците на учениците, ќе се реализираат и разновидни активности во училиштето

Со цел да се запази мултикултурализмот се планира да се организираат многубројни ивенти во училиштето и надвор од него, во соработка со локалната заедница и со други училишта кои истотака ја негуваат оваа компонента.

Во нашето училиште ќе се реализираат разновидови тематски приредби, екскурзии, претстави, маскенбали и забави. Целта на истите е учениците преку забава и креативност да осознаат нови обичаи и култури на свои соученици од различни етнички групи. Во прилог се доставува Акционен план во склоп на оваа компонента за мултикултурализмот.

Programi për Integrim ndëretnik në arsim / Програма за Меѓуетничка интеграција во образованието

Qëllimet / Цели	Aktivitetet / Активности	Realizues / Реализатор	Koha e realizimit / Време на реализација	Resurset / Ресурси	Efektete pritura / Очекувани исходи и ефекти
Vazhdim i realizimit të aktiviteteve nga projekti PINA / Продолжување на реализацијана активности од проектот ПМИО.	Planifikimi i INA aktiviteteve në programin vjetor / Планирањена МИО– активности во годишна програма.	Ekipi për integrim shkollor / Тим за училишна интеграција.	Gusht / Август.	Programi vjetor për punën e shkollës / Годишна програма за работа на училиштето.	Përgatitje e planeve aksionare për aktivitete ndëretnike për INA në Programin vjetore për punën e shkollës / Изготвени акциони планови за интегрирање на активностите за МИО во Годишната програма за работа на училиштето.
Përputhshmëria e për planifikimin e aktiviteteve në nivel shkollor / Компатибилност на планирање на активности на ниво на училиште.	Takim i përbashkët, aktivitete dhe përpunimi i raportit / Заедничка средба, активности и изработка на извештај.	Ekipi shkollore për realizimin e projektit / Тимот на училиштето за Реализација на проектот.	Gusht / Август.	Planet aksionar edhe raportet / Акциони планови и Извештаи.	Marrëveshje e përbashkët, bashkëpunim,planI për puthshëm për detyrat e caktuara / Заеднички договор, соработка, заеднички план за зададени задачи.
Mbledhje me ekipin e shkollës partnere për planifikim e aktiviteteve të përbashkëta / Состанок со тимот од партнерското училиште за планирање на заеднички Активности.	Konkretizimiaktivitet evetë përbashkëta ndërmjet dy shkollave / Конкретизирање на заеднички активности меѓу двете училишта.	Ekipet për integrim shkollor nga të dy shkollat / Тимовите за училишна интеграцијаоддвете училишта	Gusht Август.	Plani aksionar për aktivitetet e përbashkëta / Акционен план за заеднички активности.	Trajnimi i kapaciteteve shkollore për realizimin e integrimin ndëretnik në arsim / Обучени училишни капацитети за реализација на меѓуетничка интеграција во образованието.
Përforcimi i kapaciteteve shkollore për realizimin e integrimit ndëretnik në arsim / Зајакнување на училишните капацитети за реализација на меѓуетничка интеграција во образованието.	Realizimi i aktiviteteve vetanake punëtori nga arsimi për shkathtësi jetësore, aktivitete për pjesëmarrje demokratike të nxënësve / Реализација на самостојни активности, работилници од Образование за животни вештини. Активности за	-Ekip për integrim shkollor, -Arsimtare -Nxënës, -Bashkësia e nxënësve, -Ekipi për përkrahje / -Тим за училишна интеграција; -наставници -ученици -ученичка заедница -тим за поддршка.	Shtator, Qershor / Септември, Јуни.	Doracak, Programi për punëne ekipit shkollore, Programi për punë në bashkësisë se shkollës / Прирачници за ОЖВ, Програма за работа на тимот за училишна интеграција,	Zbatimi i suksesshëm i aktiviteteve të planifikuara në shkollë / Успешно спроведени планирани активности во училиштето.

	демократска партиципација на учениците.			Програма за работа .	
Koordinimi i aktiviteteve ndërmjetshkollavepartnere, pjesëmarrjenëmbledhjepër shkëmbim të përvojave me shkolla tjera / Координирање на активностите меѓу партнерските училишта чество на средби за размена на искуства со другите училишта.	Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta: Mësim i rregullt – mësim në disa lëndë, projekte kërkimore brenda lëndëve; Aktivitete jashtëshkollore - shëtitje, ekskursione, ngjarje, projekte-seksione, lojëra sportive. / Реализација на заеднички активности: Редовна настава – настава по некои предмети, истражувачки проекти во рамки на предметите; Воннаставни активности – излети, екскурзии, приредби.	-Ekip për integrim shkollor, Arsimtare, -prind, -Nxënës / тимовите за училишна интеграција на двете училишта наставници -родители -ученици.	Janar– Qershor / јануари – јуни	-Planet aksionare, -Programipër pune, -Përgatitje ditore, tematike rregulloret / -акциони планови -програми за работа -дневни, тематски планирања Правилници.	Gadishmeria për bashkepunim dhe interakcion Realizimi i suksesshem i aktivteteveper integrim nderetnik me shkollat partnere / -Подготвеност за соработка и интеракција -Успешно реализирани активности за меѓуетничка интеграција со партнерско училиште.
Inicim i aktiviteteve për inkuadrimin e prindërve dhe Komunës për integrim ndëretnik në arsim dhe koordinimin e realizimit të saj / Иницирање активности за вклучување на родителите и Општината во активностите за меѓуетничка интеграција во образованието и координација на нивната реализација.	Bashkëpunim me prindërit dhe Komunën / Соработка со родители и Општината.	-Ekip për integrim shkollor Arsimtare -Prind -Nxënës Këshilli i prindërve këshilli i shkollës / тим за училишна интеграција; наставници ученици Совет на родители Училишен одбор.	Shtator Qeshor / Септември – Јуни.	Planet aksionare Programipër pune Rregulloret / -акциони планови -програми за работа Правилници.	Inkuadrim aktiv dhe përkrahje në implementimin dhe promovimin e aktiviteteve vetanake (të panvarura) / Активно вклучувањеи поддршка во спроведување и промовирање насамостојните и заедничките активности.

Lënda, fushat garuese / Предмет натпрев, подрачје	Arsimtarët përgjegjës / Одоговрни наставници	Klasa / Одделение	Garashkollore / Училиштен натпревари	Gara komunale / Општински натпрвар	Gara regjionale / Регионален натпревар	Gara shtetërore / Државен натпревар	Gara nderkombetare / Меѓународен натпревар
Kori dhe orkestra / Хор и Оркестар	Laureta Fetai	VI-IX		Shfaqjet e orkestrës dhe korit / Настапи на оркестар и хор			
Arsimi figurativ / Ликовно образование	Arbina Bexheti	VI-IX					
Arsimi fizik dhe shëndetësor / Физичко и здравствено образование	Izedin Murati Xhemal Dehari Altrim Memeti Vjollca Alili	VI, VII, VIII, IX	Futboll Basketboll Hendboll / Фудбал Кошарка Ракомет	Futboll, basketboll, volejboll, hendboll, ping- pong (meshkuj dhe femra) / Фудбал, кошарка, одбојка, ракомет, пин-понг (машки и женски)			
Arsimi fizik dhe shëndetësor / Физичкои здравствено образование	Të gjithë arsimtarët klasor / Сите одделенски наставници	I-III	Tetor / Октомври				
Arsim teknik / Техничко образование	Nexhbedin Aliu	V,VI,VII	Tetor / Октомври		Prill / Април		

14. Projektet që realizohen në shkollën fillore /
14. Проекти што се реализираат во основното училиште

- Projekt për implementimin e Edukimit Ekologjik në Sistemin Arsimor të Maqedonisë – përkrahur nga MASH;
- Projekt për Integrimin Ndëretnik–projekti i USAID, përkrahur nga MASH dhe BZHA;
- Projekt për përdorimin e IKT në procesin mësimor;
- Projekt për "Reciklimi" ekologjia;
- Projekt për ushqimin e shëndosh.

- Проект за имплементација на еколошко образование во образовниот систем на Македонија-поддржан од МОН;
- Проект за меѓуетничка интеграција-проект на УСАИД, поддржан од МОН и БРО;
- Проект за употреба на ИКТ во наставниот процес;
- Проект за рециклирање екологија;
- Проект за здрава храна.

Projekti Проект	Qëllimi / Цел	Realizues / Реализатор	Koha e realizimit / Време на реализација	Përkrahur / Подржан
Edukimi Ekologjik në Sistemin Arsimor të Maqedonisë / Имплементација на еколошко образование во образовниот Систем на Македонија.	Ndergjegjësim për kujdesin ndaj rrethit ku jetojm / Свесност за грижата за околината во која живееме.	Ekipi ekologjik / Еколошки тим.	Shtator-qershor / Септември-јуни.	Shkolla / Училиште..
Integrimi ndëretnik / Меѓуетничка интеграција.		Ekipi i integrimit ndëretnik / Тимот за меѓуетничка Интеграција.	Shtator-qershor / Септември-јуни.	Shkollat / Училиштата
Përdorimi i IKT në procesin mësimor / Употреба на ИКТ во Наставниот процес.	Ritja e interesit dhe cilësis së punës / Зголемување на интересот и квалитетот на работата.	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници.	Shtator-qershor / Септември-јуни.	Shkolla / Училиште
Projekt për "Reciklimi" ekologjia / Проект за рециклирање екологија.	Ngritja e vetëdijes për ruatjen e ambientit / Подигнување на свеста за заштита на животната средина.	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници.	Maj / Мај.	Ekologik / Екологик / Shkolla / Училиште.
Projekt për ushqimin i shëndosh / Проект за здрава храна	Të fitoj njohuri se ushqimi i shëndosh ndikon në mësim / Да стекнете сознанија дека здравата храна влијае на учењето.	Të gjithë arsimtarët / Сите наставници	Prill / Април	Shkolla / Училиште

15. Mbështetja e nxënësve / 15. Поддршка на учениците

15.1. Arritjet e nxënësve / 15.1. Постигањата на учениците

Shkolla disponon me të dhëna për arritje të nxënësve në të gjitha lëndët mësimore për të gjitha periudhat e klasifikimit. Bëhen krahasime në suksesin e mesëm, sjelljen dhe mungesat, si dhe arritjeve sipas gjinisë së nxënësve. Përkatësia etnike nuk paraqitet si variabël e arritjeve të nxënësve, sepse nuk ka pjesëtarë të grupeve tjera etnike.

Shkolla promovon bindje se arritjet e të gjithë nxënësve mund të përmirësohen dhe organizon mësim plotësues, shtues dhe aktivitete të lira. Secili mësimdhënës në fillim të vitit shkollor harton program vjetor për këto forma të mësimit. Në nivel të mësimit në fjalë përpilohet orari për realizimin e këtyre programeve, sipas numrit të planifikuar të orëve plotësuese dhe orëve për aktiviteteve të lira në korniza të një paralelje. Për mësimin plotësues janë hartuar edhe njoftime të posaçme për prindërit e nxënësve në të cilat janë të vërejtura vështirësitë në nxënien e materialit për lëndë të veçanta. Gjithashtu, mësimi i rregullt në vijimë si përparon me projekte, teknika dhe metoda të reja të punës.

Nxënësit me vështirë në mësim, por edhe ata me nevoja ndryshe arsimore, së pari identifikohen gjatë observacionit gjatë kohës së regjistrimit në klasën e parë (pyetësorët në të cilat prindi vetë sugjeron në probleme të fëmijës, mendimet nga Enti i Shëndetit Mental, vërtetimi i mjekut), e nëse më vonë vërehen probleme, bisedohet me mësimdhënësin, nxënësin dhe prindin – dhe konsultohen institucionet kompetente.

Nxënësit e talentuar identifikohen përmes observacionit të mësimdhënësit të orës – shënimeve të anekdotës, notave, evidencës personale të secilit mësimdhënës veçmas.

Në shkollë nuk kryhet testimi intern në kuptimin e vërtetë të fjalës, por bëhen testime në formë të garave interne në lëndë të ndryshme në nivel të gjeneratës, se si do të selektohen nxënësit të cilët do të marrin pjesë në garat e organizuara.

Në shkollë është miratuar Rregullorja për lëvdatat dhe shpërblimet e nxënësve dhe me këtë Rregullore zgjidhet paralelja më e mirë, nxënësi i gjeneratës, shpërblehen nxënësit që kanë arritur sukses të shkëlqyeshëm në vijimë si gjatë shkollës fillore dhe nxënësit që kanë kontribuar për afirmimin e shkollës.

Informimi i nxënësve dhe opinionit të gjerë për punën dhe rezultatet që i arriti shkolla do të zhvillohet në vijimë si

Училиштето располага со податоци за постигањата на учениците по сите наставни предмети за сите периоди на класификација. Се прават споредби на средниот успех, поведението и изостаноците, како и на постигањата според полот на учениците. Етничката припадност не се појавува како варијабла кај постигањата на учениците бидејќи нема припадници на други етнички групи.

Училиштето промовира уверување дека постигањата на сите ученици може да се подобрат и организира дополнителна, додатна настава и слободни активности. Секој наставник на почетокотна учебната година изготвува годишна програма за овие форми на настава. На ниво на предметна настава се изработува распоред за реализација на овие програми, според планираниот број на додатни, дополнителни часови и часови за слободни активности во рамките на една паралелка. За дополнителната настава изготвени се и посебни известувања до родителите на учениците кај кои се воочени потешкотии во совладувањето на материјалот по поедини предмети. Истотака, редовната настава во континуитет се унапредува со нови проекти, техники и методи на работа.

Учениците со тешкотии во учењето, а и оние со посебни образовни потреби, најпрво се идентификуваат при опсервацијата за време на уписот во прво одделение (прашалници вокои родителот сам укажува на проблеми со детето, мислења од Заводот за ментално здравје, лекарска потврда), а до колку по доцна сево очи проблем, се разговара со наставникот, ученикот и родителот, и се консултираат компетентни институции.

Надарени ученици се идентификуваат преку опсервација на наставникот на часот, анегдотски белешки, оцени, лична евиденција на секој наставник одделно.

Во училиштето не се врши интерно тестирање во вистинска смисла на зборот, но се прават тестирања во форма на интерни натпревари по различни предмети на ниво на генерација, како би се селектирале најдобрите ученици кои ќе учествуваат на организираните натпревари.

Во училиштето е донесен Правилник за пофалби и наградување на ученици и со гласно овој Правилник се избира најдобра паралелка, ученик на генерација, се наградуваат ученици кои постигнувале континуиран одличен успех во текот на основното образование и ученици кои допринеле за афирмација на училиштето.

Информирање на учениците и на пошироката јавност за работата и резултатите што ги постигнува училиштето ќе се одвива

gjatë tërë vitit. Informimi bëhet përmes fjalimeve publike të drejtpërdrejta të drejtorit apo personit të autorizuar nga shkolla, revistave dhe gazetave të ndryshme, listave profesionale, si dhe revistave tjera profesionale, si dhe përmes radios dhe televizionit dhe faqes së shkollës në rrjetet sociale.

Shkolla nuk i ndjeka rritjet gjatë kalimit nga arsimi fillor në arsimin e mesëm. Në shkollë arrin njoftimi se në cilat shkolla të mesme e kanë vazhduar arsimin e tyre nxënësit tanë, por jo edhe informatat për arritjet e tyre në mjedisin e ri. Si ndihmë gjatë vendosjes së nxënësve në zgjedhjen e shkollës së mesme në të cilën do të regjistrohen, psikologu i shkollës harton dhe realizon Program për orientimin profesional për nxënësit e klasës së IX-të. Nëse ekzistojnë mundësi do të organizohet një vizitë nga nxënësit në shkolla të mesme, apo të sigurohen ligjërues që do t'i njoftojnë nxënësit me profesione të ndryshme. U organizuan edhe vizita e Panairit të Arsimit ku u prezantuan shkollat e mesme të Republikës së Maqedonisë Veriore.

